



---

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e jashtëzakonshme e (III-të për v. 2011) e**  
**Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 21.4. 2011**

---

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:00**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Ergin Sungurit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, Dibran Përçuku ,nënkryetar i Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

**R E N D I T E**

1. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi aprovimin e Planit Rregullues Urban (Zona I,II,II).**
2. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit Zonë ekonomike për ndërtimin e parkut të biznesit në fsh.Lumëmadh.**
3. **Shqyrtimi i Propozim-vendimi për lejimin e mjeteve financiare nga Fondi për bashkëfinancim në vlerë prej 72.407 € për asfaltimin e rrugës “Hamit Hyseni”.**

***Në vazhdim, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” dhe tjerët “abstenim” aprovoi rendin e ditës.***

## **1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi aprovimin e Planit Rregullues Urban (Zona I,II,III).**

**Idriz Ismajli, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit-** paraqiti sqarimet e tij në linja të përgjithshme sa i përket Planit rregullues urban. Duke bërë prezantimin e shkurtër të këtij plani ai shtoi se plani rregullues urban është i përfshirë në tri zona dhe atë: Zona e "Qendrës" që përfshin një sipërfaqe prej 25.22.61ha, Zona e quajtur "Ura e Gurit" me sipërfaqe prej 36.14.96 ha, si dhe Zona buzë "Lumit Tërstena" me sip. prej 18.04.48 ha, pra janë gjithsej tri plane rregulluese që përfshijnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 80.00.00 ha. Gjithashtu, ai ceku se për hartimin e këtij plani janë mbajtur afërsisht 20 takime, dhe këto takime kryesisht kanë qenë me grupin profesional i cili ka qenë i formuar nga Kryetari i Komunës dhe në të cilin kanë marrë pjesë anëtarë nga Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike. Njëkohësisht ai njoftoi se janë mbajtur 2 takime me qytetarët e këtyre zonave si dhe diskutimi publik nga 10 janari deri më 10 shkurt 2011, dhe vërejtjet e dhëna nga këto takime janë marrë parasysh dhe si të tilla edhe janë inkorporuar aty ku është parë e nevojshme.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** tha se sipas ligjit për planifikim hapësinor 2003/14 është e drejtë ekskluzive e kuvendit që të marrë vendim për hartimin e planit zhvillimor komunal, dhe zhvillimor urban por njëkohësisht edhe planet rregulluese. Ai vazhdoi duke shtuar se ne e dimë që një vendim i tillë nuk është marrë, andaj edhe kërkoi sqarime lidhur me këtë. Njëkohësisht ai ceku dhe kërkoi që të bëhet e ditur arsyeja, si dhe kush ka qenë ai që ka vendosur që pa vendim të kuvendit të zgjidhen pikërisht këto tri zona që të hartohet plani rregullues urban, kur dihet se këto tri zona janë më së paku të atakuara me ndërtime të përditshme. Ndërsa, ne e dimë se në zonat tjera të qytetit, verës gati çdo ditë fillon ndërtimi i objekteve pa një plan rregullues. Në fund ai shtoi se ky plan i cili është bërë pa vendim të kuvendit si i tillë është i paligjshëm.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se plani rregullues urban është dashur të kaloi në procedurat e kuvendit, sepse një sipërmarrje kaq e madhe siç është plani rregullues urban të hartohet pa kaluar nëpër procedurat e kuvendit është anomali e madhe. Në vazhdim ai bëri disa pyetje lidhur me këtë plan, duke thënë se cili ka qenë kriteri i përzgjedhjes siç tha ai për zonat sekondare, pastaj pyeti se përse është shkruar se toka është jopjellore. Andaj shtoi se Drejtoria e Bujqësisë është mirë që të mendojë para se të shkruaj kështu, sepse dihet se kjo tokë nuk ka qenë jopjellore, por se ne për shkak të rëndësisë së këtij plani këto zona i kemi shpallur si zona me interes të veçantë.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit –** sqaroi se kuvendi ka marrë vendim për hartimin e planit rregullues urban, ndërsa sa i përket zonave I,II dhe III është kompetencë e kryetarit dhe e Drejtorisë së Urbanizimit që të vendos për përzgjedhjen e tyre.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës –** tha se është kuvendi ai i cili e ka miratuar planin zhvillimor komunal, ku janë të përfshira 17 zona në të, dhe tani nuk mund t'i kthehemi sërish atyre vendimeve të kuvendit sepse tashmë ato janë shndërruar në ligj, dhe në kuadër të kësaj është hartuar edhe plani rregullues. Ai tutje shtoi se sa i përket përzgjedhjes së këtyre tri zonave për të cilat është hartuar, mund të them se ne si ekzekutiv e kemi autorizuar Drejtorinë e Urbanizimit që të bëjë përzgjedhjen e këtyre zonave pasi që kemi menduar se kjo është më e arsyeshme.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit –** tha se marrja e qëndrimeve apo vendimeve në këtë formë kaq urgjente në seancë të jashtëzakonshme nuk është e nevojshme sepse kjo nuk është çështje e lëmisë së jashtëzakonshme, dhe shtoi se kemi mjaft çështje tjera të natyrës urgjente, e ku ceku problemin me energji elektrike dhe regjimin e ashpër të reduktimeve. Ai në vazhdim shtoi se është e detyrueshme që të respektohet forma në nxjerrjes së vendimeve, duke iu referuar

planit rregullues urban. Gjithashtu, ai ceku se është mirë të shikohet ligji, mbi kompetencat e komunës, kompetencat e kryetarit, kompetencat e ekzekutivit, dhe të Kuvendit, dhe shohim se është organi më i lartë i cili vendos për këso dokumentesh të natyrës kaq të rëndësishme siç është plani rregullues urban. Tutje ai shtoi se pjesëmarrja e qytetarëve në debate publike ka qenë simbolike rreth shprehjes së mendimit, ndërsa sa i përket prioriteteve ai tha se është kuvendi kompetent absolut për caktimin e zonave, prioriteteve dhe ndarjen e qytetit, dhe në kuadër të kësaj një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet "tokës së bukës", sistemit të ujitjes, dhe sistemit të komasacionit.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës** – sqaroi se plani rregullues urban është një dokument i një rëndësie të veçantë, andaj ne e kemi parë të arsyeshme që ta thirrjmë një seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e tij.

**Dukagjin Hasimja, ekspert i urbanizmit**- paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me planin rregullues urban. Në veçanti ai u ndal lidhur me sqarimet e tri zonave urbane (Zonat: I, II dhe III) të planit rregullues urban.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit**- pyeti se a do të rregullohet problemi lidhur me ngushticat (fytet) në qytet, tek varrezat si dhe ajo tek xhamia, pasi që dihet se është bërë ngarkimi i qytetit pas mbylljes së rrugës kryesore. Tutje ai vazhdoi duke pyetur se a do të ruhet vija e ndërtimeve tek ndërtesa përballë Kalasë për shkak se nga këto hapësira varet edhe ndërtimi i bulevardëve, dhe hapësirave gjelbëruese.

**Dukagjin Hasimja, ekspert i urbanizmit**- tha se tek hapësirat te Kalaja janë duke vazhduar hulumtimet arkeologjike dhe arkitektonike, andaj sigurisht se në këtë hapësirë ka edhe muraja, andaj edhe është një situatë vështirë e zbërthyeshme, por se zgjidhja më e mirë do të ishte heqja e objekteve që ndodhen përrreth. Ndërsa sa i përket ngushticave (fyteve), ai tha se këto rrugë janë për qasje në qytet, andaj edhe është menduar se gjerësia e tyre të jetë 9 metra.

**Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit**- tha se nëse qendrës tregtare i shtohen edhe dy kate të cilat do të shfrytëzoheshin për banim, atëherë do të bëhej një ngufatje e tmerrshme e qytetit.

**Avdullah Halimi, anëtar i Kuvendit**- pyeti se cilat kanë qenë kriteret bazë apo të përgjithshme për kategorizimin e zonës I, II dhe III të planit rregullues urban, që përcaktojnë një vijë ndarëse në mes këtyre tri zonave. Tutje pyeti se në bazë të këtij planit si është menduar të rregullohet hapësira ndërmjet objektit "Viva" dhe Xhamisë?

**Dukagjin Hasimja, ekspert i Urbanizmit**-tha se për këtë hapësirë akoma jemi në një plan ideor, që kjo hapësirë të jetë si shesh, është planifikuar që poshtë këtij sheshi të jetë një qendër biznesi.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**- tha se këtë projekt ideor, tek objekti "Viva" i cili është futur në plan, është bërë me kërkesën e tij, d.m.th. hartuesi i planit nuk ka qenë i obliguar që ta bëjë këtë.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit**- tha është mirë që të mendohet për të ardhmen që me ndërtimet që bëhen mos të zihet toka bujqësore (e bukës), dhe shtoi se duke i marrë parasysh vërshimet e vitit 1979, vlerësoi se nuk do ishte mirë që zgjerimi i qytetit të bëhet në këto pjesë që janë paraparë me këtë plan rregullues urban, pasi që këtë pjesë e sidomos zona e quajtur "Ura e Gurit" është tokë e ultë dhe sigurisht që do të kemi probleme në të ardhmen. Në vazhdim ai ceku se është me rëndësi që në këtë plan, t'i kushtohet një vëmendje trashëgimisë kulturo-historike (legjendave). Ndërsa, kur është fjala te sistemi shkollor, ai shtoi se është bërë një gabim ku thuhet: se mësimi organizohet në tri nivele, ndërsa dihet se mësimi organizohet në katër nivele. Në fund ai tha se është e udhës që para se të miratohet ky plan, të merren për bazë vërejtjet e dhëna nga ekspertët arkitektonik.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit** – tha se ne parimisht po e kryejmë një obligim ligjor rreth çështjes së rregullimit të ambientit, mirëpo shtoi se nga vet struktura e ndërtimit, dhe nga zonat që janë përzgjedhur shihet qartë se ka gërshetim të interesave të caktuara. Në vazhdim ai ceku se gjatë hartimit të këtij plani është dashur të merren parasysh disa parametra siç janë: pozita gjeografike e qytetit, kuota mbidetare, mandej çështja e lumit si dhe çështjet e vërshimeve. Gjithashtu, ai shtoi se një ndër çështjet tjera është çështja e tokës bujqësore (bukës) e cila po zihet me ndërtime, dhe shtoi se ne kemi tokë të pa plleshme e cila do të mund të shfrytëzohej për ndërtime.

**Dukagjin Hasimja, ekspert i urbanizmit**- tha këto plane dalin nga plani zhvillimor urban të cilin ju vet e keni miratuar, andaj shtoi se nuk ka asnjë hapësirë me tokë bujqësore e cila po zihet me ndërtime, por se të gjitha janë zona urbane.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit**- tha se thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme më së miri tregon për rëndësinë e madhe që ka ky plan. Ai shtoi se nëse e shikojmë qytetin, në hyrje nga Prishtina atëherë shohim se është bërë zgjerim i rrugës kryesore, dhe të gjithë e ndiejnë veten mirë me këtë, dhe shtoi se hartuesit e këtij plani është dashur të kenë parasysh se për një qytet funksional kryesore është arteria kryesore e tij (d.m.th. rruga kryesore e cila kalon nëpër qytet), dhe po që se kjo arterie (rrugë) është e ngushtë, atëherë qyteti është i ngulfatur. Duke iu referuar gjendjes në qendër të qytetit “rruga kryesore” dhe objektit tek komuna ai tha se këto ndërtime janë bërë jashtë çdo interesi të përgjithshëm. Gjithashtu ai tha se ndërtimet që janë bërë në qytet, sidomos në “qendër” janë jashtë çdo standardi profesional, urbanistik dhe arkitektonik, dhe rrjedhimisht nga kjo qyteti është ngulfatur. Në fund ai iu bëri thirrje hartuesve të këtij plani, që t’i kenë parasysh këto fakte si dhe shqetësimet e qytetarëve.

**Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit**- pyeti se sa është ruajtur identiteti i qytetit të Vushtrrisë me këtë plan, veçanërisht objektet kulturo –historike si: “Kalaja”, “Ura e Gurit”, “Hamami” si dhe “Shtëpia e Hasan Prishtinës”, dhe sa është inkorporuar trashëgimia kulturore në këtë plan urbanistik.

**Dukagjin Hasimja, ekspert i urbanizmit**- tha se tek “Ura e Gurit” sipas kriterëve nuk guxon të ndërtohet në afërsi prej 50 metrave, gjë kjo e cila është respektuar, pastaj në “Kala” kanë filluar disa hulumtime dhe janë gjetur disa mure mjaft të vjetra në brendi të Kalasë e tutje, ai shtoi se këso muresh mund të ketë edhe jashtë apo për rreth Kalasë, kështu që zgjidhja më e mirë kishte me qenë rrënimi i këtyre objekteve, apo blerja e tyre ku do të bëhej një bllok urbanistik, dhe do të fillonin gjurmimet arkeologjike.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**- tha se jemi munduar që t’i kushtojmë një rëndësi të veçantë trashëgimisë kulturore dhe historike edhe në planin rregullues urban. Tutje ai shtoi se kemi një projekt për restaurimin e “Hamamit” si dhe ndërtimin e shtatores së “Hasan Prishtinës”. Në fund ai propozoi që plani rregullues urban të votohet zonë për zonë.

**Ferit Idriizi, kryesues i Kuvendit**- tha se pasi që nuk pati vërejtje serioze sa i përket planit rregullues urban, atëherë shumë më e arsyeshme është që plani të votohet ashtu siç është në tërësi.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit**- tha se është një përgjegjësi e madhe para se të votohet ky plan, andaj shtoi se jam dakord që plani të votohet zonë për zonë. Në vazhdim ai tha se nga pyetjet që u shtruan këtu, ne nuk morëm përgjigje, dhe shtoi se ne nuk duhet të lejojmë që “tokat e bukës” nga lumi “Sitnica” e deri afër stacionit të zihen me ndërtime.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**- propozoi që të shkohet sipas tri projekteve (zonave) të planit, por që në pika të veçanta të ndalemi dhe t’i analizojmë, sepse në zona kemi nivele të ndryshme të ndërtimit, mandej ai tha se a po pajtohemi që të kemi ndërtime në zonën tek “lumi Sitnica”, dhe për të gjitha këto pika duhet të gjendet një gjuhë e përbashkët.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** propozoi që për planin ideor tek objekti “Viva” të mos ketë ndërtime, por që ajo hapësirë të gjelbërohet për shkak se siç tha ai nga këto ndërtime është ngulfatur qyteti.

**Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit-** tha se për planin ideor jemi që ndërtimet të jenë P+2, dhe shtoi se jemi kundër zgjerimit të qytetit në anën perëndimore, për faktin se jemi për ruajtjen e tokës bujqësore. Në fund ai propozoi që zgjerimi i qytetit të ndodh në pjesën lindore të qytetit (në “Vreshta”).

**Dukagjin Hasimja, ekspert i urbanizmit-** tha se në pjesën tekstuale të planit janë bërë disa lëshime, por se pas disa konsultave profesionale edhe me stafin e urbanizmit kemi vendos që sipërfaqja më e vogël për një objekt P+4 deri P+8 duhet të jetë minimumi 0.010.00 ha.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 11 “kundër” të tjerët “abstenim”, vendosi me sa vijon:**  
***Aprovohet Plani Rregullues Urban i qytetit të Vushtrrisë, zona e I, II dhe III-të për periudhën 2011-2015.***

***Zona e I-rë (zona e qendrës) përfshin sipërfaqen prej 25.22.61 ha.***

***Zona e II-të (zona Ura e Gurit) përfshin sipërfaqen prej 36.14.96 ha.***

***Zona e III-të (zona buzë lumit “Tërstena”) përfshin sipërfaqen prej 18.08.48 ha.***

**2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit Zonë Ekonomike për ndërtimin e parkut të biznesit në fsh. Lumëmadh.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** sqaroi se vendimi për caktimin e zonës ekonomike është nxjerr më herët, por se pas një konsulte që kam pasur me Sekretarinë e Kuvendit, më kanë informuar se vendimin në fjalë nuk e kanë në dosjet e dokumentacionit të sekretarisë, andaj kemi qenë të detyruar që përsëri ta sjellim në Kuvend për shqyrtim, me qëllim që ta kompletojmë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta dërgojmë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se në rastet ku propozim-vendimet e tilla vijnë në Kuvend, është mirë që gjithmonë të konsultohen drejtoritë përkatëse. Dhe shtoi se në rastin konkret do të ishte evituar ky lëshim, ku është cekur se toka ku është paraparë ndërtimi i këtij parku është “jo pjellore”. Ai tutje ceku se Drejtoria e Bujqësisë nuk është dashur të lejoj që ky dokument të vijë në kuvend me këtë gabim, dhe propozoi që drejtoria në fjalë ta heqë këtë pasusin “tokë jo pjellore.”

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** tha se ky vend i propozuar për park nuk është i përshtatshëm për biznes, dhe shtoi se toka në fjalë gjendet nën komasacion dhe sigurisht se kjo tokë është e klasit të parë. Në fund ai tha se komuna ka tokë tjetër “jo të plleshme” që është më e përshtatshme për ndërtimin e këtij parku të biznesit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, 3 “kundër”, të tjerët abstenim, vendosi me sa vijon:**

***Më këtë vendim caktohet lokacioni - Zonë Ekonomike për ndërtimin e parkut të biznesit në pjesë të parcelave kadastrale nr. 435/1 dhe 435/3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 14.86.00 ha, me kulturë jo pjellore e evidentuar në certifikatën e pronësisë UL-70202011-00070, Zona Kadastrale Lumëmadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.***

**3. Shqyrtimi i Propozim-vendimi për lejimin e mjeteve financiare nga Fondi për bashkëfinancim në vlerë prej 72.407 € për asfaltimin e rrugës “Hamit Hyseni”.**

**Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike-** paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim”, vendosi me sa vijon:**

***Lejohen mjete financiare nga buxheti i Komunës- fondi për bashkëfinancim, në shumën prej 72.407 € për asfaltimin e rrugës “Hamit Hyseni” (ish-Ekonomia e Pyjeve).***

**Mbledhja përfundoi në orën 14:30.**

**Procesmbajtësi:  
Bastri Duraku**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**